



REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Në çështjen juridike të :

AC-I-16-0100

Xh.M. Prishtinë

Paditësi/Ankuesi

Kundër:

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) rr. "Agim Ramadani" 23, Prishtinë,

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Ilmi Bajrami Gjyqtar kryesues, Sabri Halili dhe Mr. sc. Sahit Sylejmani, gjyqtarë duke vendosur sipas ankesës së paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca te deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-2827 të datës 05 maj 2016 pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 26 shtator 2019, lëshon këtë:

A K T V E N D I M

- 1. Ankesa e paditësit është e bazuar.**
- 2. Anulohet, Aktgjykimi i gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, C-IV-13-2827 të datës 05 maj 2016.**
- 3. Lënda kthehet për rigjykim në Shkallën e I-rë të DHPGJS-së.**
- 4. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.**

Rrethanat faktike dhe procedural

Me datë 05 nëntor 2013, ankuesi ka parashtruar një ankesë në DHPGJS-së për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, nr. PRN047-0455 të datës 10 tetor 2013 (më tutje AL) me të cilin ishte refuzuar si e pavlefshme kërkesa e tij për kompensimin shtesë të mjeteve financiare të hyra nga qiraja e objekteve të NSH "A" në Prishtinë (në likuidim).

Në ankesën e vetë, ankuesi ka theksuar se menagjmenti i NSH-së, shumën e mjeteve financiare prej 2.160.380.48 euro, të hyra nga pagesa e qirasë së ambienteve të NSH-së, ua kishte ndarë punëtorëve në mënyrë arbitrare, jo të barabartë dhe pa kritere. Ankuesi ka theksuar se nga këto mjete është kompensuar në shumë prej 712.96 euro, ndërsa është dashur të kompensohej në shumë prej 5.784.61 euro. Ankuesi ka kërkuar që të anulohet vendimi i autoritetit të likuidimit, të aprovohet ankesa e tij dhe të i njihet e drejta e kompensimit në shumë prej 5.784.61 euro, duke zbritur shumën prej 712.96 euro të cilën e ka pranuar.

Më 20 maj 2014 Dhoma e Posaçme e dërgoj ankesën e ankuesit tek AKP-ja e cila në mbrojtjen e saj të datës 16 korrik 2014 i propozoj gjykatës që ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pa bazuar dhe të vërtetoj vendimin e autoritetit të likuidimit të AKP-se. Duke theksuar se mjetet financiare të hyra nga qiraja ambienteve NSH-së, komisioni për shpërndarjen e mjeteve të NSH-së, me vendim nr.379/1, datë 23 dhjetor 2010 i kishte shpërndarë mjete punëtorëve, ndaj të cilit punëtorët kishin të drejte në afat prej 15 ditëve, të parashtroj ankesë pranë Komisionit për shpërndarje.

AKP-ja, konsideron se një kërkesë e tillë është e përmbushur pasi që ankuesi kishte pranuar mjetet të cilat i ishin ndarë nuk kishte kundërshtuar vendimin e komisionit për shpërndarjen e mjeteve të NSH-së dhe së tani AL nuk ka kompetenca të anuloj një vendim të tillë.

Më 08 gusht 2014, Dhoma e Posaçme, e dërgoj mbrojtën e AKP-së te ankuesi, për parashtrimin e përgjigjes ndaj saj. Me 19 gusht 2014 përfaqësuesi i ankuesit, kundërshton mbrojtjen e të paditurës lidhur me mos ushtrimin e ankesës kundër vendimit të komisionit për shpërndarje të mjeteve, duke theksuar se në momentin kur është vendosur për shpërndarjen e mjeteve nga komisioni, nuk ka qenë punëtor aktiv i NSH-së, nuk ka qenë i informuar personalisht për atë vendim, dhe si rrjedhojë e saj, nuk e ka kontestuar. Andaj i propozon gjykatës që ankesa e tij, të aprovohet si e bazuar.

Më 04 shtator 2014 AKP-ja ka parashtruar kundërpërgjigjen ndaj përgjigjes së përfaqësuesit të ankuesit, e cila sikur edhe në mbrojtjen e parashtruar më herët, i ka propozuar gjykatës që ankesa të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet vendimi i AL.

Me datë 05 maj 2017, gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar merr Aktgjykimin C-IV-13-2827 me të cilin e refuzon ankesën e ankuesit si të pabazuar duke e vërtetuar Vendimin e AL si të drejtë dhe të bazuar në ligj. Gjyqtari i vetëm me kompetenca të deleguara i Kolegjit të Specializuar ka konstatuar se ankuesi nuk e kishte kundërshtuar dhe e kishte pranuar një shumë të mjeteve të ndara për punëtorët të caktuar me këtë vendim. Tutje konstaton se pretendimi i ankuesit se në momentin e ndarjes së mjeteve nuk ka qenë punëtor aktiv dhe nuk ka qenë i informuar për këtë arsye nuk ka bërë kundërshtim në afatin e duhur kohor, është i papranueshëm sepse vendimi ka qenë në tabelën e shpalljes dhe një numër i madh i punëtorëve kishte bërë kundërshtime e që këto kundërshtime ishin shqyrtuar nga menaxhmenti i NSH-së.

Me datë 17 mars 2016, ankuesi e ka dorëzuar në DHPGJS një ankesë të afatshme kundër Aktgjyimit të gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së C-IV-13-2827 të datës 05 maj 2016 (më tutje Aktgjykimi i ankimuar), dhe kërkon nga Kolegji i Apelit që të aprovohet ankesa e tij të priset Aktgjykimi i ankimuar dhe lënda të kthehet në rigjykim ose ti aprovohet kërkesa e tij që ti njihet kompensimi i pretenduar me ankesën para Kolegjit të Specializuar deri në shumë prej 5.784.61 euro. Për më tepër në ankesë, ankuesi

pretendon se nuk është i drejtë përfundimi i Gjykatës së Shkallës së I-rë se Autoriteti i Likuidimit nuk ka kompetencë të anulojë vendimet e Komisionit të NSH-së për shpërndarje të mjeteve të qirasë, ngase ky Autoritet vendos për kërkesat e punëtorëve ndaj ndërmarrjes në likuidim. Objekt i kërkesës ishte e drejta në pagesën e punëtorit nga marrëdhënia e punës dhe lidhur me punën përkatësisht kompensimin e punëtorit nga mjetet e inkasuara të qirasë. Gjykata e Shkallës së I-rë sipas ankuesit nuk ka dhënë arsytim për bazën ligjore të formimit të Komisionit dhe shpërndarjen e mjeteve financiare të mbledhura nga qiraja e objekteve afariste. Nuk janë dhënë arsye se këto veprime të Komisionit a ishin në pajtim me ligjin. Nuk është ofruar asnjë arsye e cila shpjegon pse ankuesi nga pozita e punëtorit nuk kishte të drejtë të marrë pjesë aktive në vendimmarrje, në procedurën e themelimit të komisionit dhe përcaktimit të kriterëve të ndarjes së mjeteve si dhe nuk janë dhënë bazat ligjore mbi cilën bazë ndërmarrja ka pasur të drejtë të afishojë vendimet në tabelën e shpalljeve dhe mos ti njoftoj personalisht punëtorët për vendime lidhur me shpërndarjen e mjeteve nga qiraja. Sipas ankuesit vendimi i Bordit menagjues të NSH-së nr. 379/1 është në kundërshtim me aktet normative të ndërmarrjes dhe ai duhet të anulohet. Ankuesi gjithashtu pretendon se atij nuk i është dhënë mundësia të ushtrojë ndonjë mjet juridik kundër procedurës së shpërndarjes së mjeteve financiare, përfshirë dhe vendimin nr. 379/1, pasi që ai vendim asnjëherë nuk i është dorëzuar personalisht. Të lartë cekurat mund të vërtetohen edhe nga praktika e Kolegjit të Apelit në lëndën AC-I-14-0346 të datës 30 korrik 2015.

AKP-ja i kundërshton të gjitha pretendimet e paditësit të paraqitura në ankesën e tij, duke i konsideruar si të pabazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet. AKP-ja në tërësi e mbështet Aktgjykimin, C-IV-13-2827 duke e konsideruar të drejtë dhe të ligjshëm.

Arsyetimi ligjor

Ankesa është e bazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr.06/L-086 për DHPGJS, Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Kolegji i Apelit, pasi që shqyrtoi pretendimet ankimore, Aktgjykimin e ankimuar dhe provat në shkresat e lëndës, gjeti se ankesa është e bazuar dhe lënda duhet të kthehet në rigjykim në bazë të arsyeve vijuese.

Autoriteti i Likuidimit(AL) refuzimin e kërkesës së parashtruesit e ka bërë pa ndonjë arsye specifike. AL nuk ka pasur ndonjë bazë ligjore për refuzimin e kërkesës së parashtruesit me arsyen se ai nuk e ka kontestuar listën në afatin e përcaktuar. Kolegji i Apelit gjeti se afati i përcaktuar nga NSH-ja dhe AKP-ja nuk mund të ketë efekt të afatit prekluziv.

Është e qartë se kërkesa e parashtruesit është një kërkesë kreditore ndaj NSH-së, ndërsa afatet për parashtrimin e kërkesave kreditore janë të sanksionuara me Ligjin e AKP-së nr.03/L-67 që nuk përkojnë me afatet e përcaktuara sipas vendimit mbi ndarjen e këtyre mjeteve monetare.

Kolegji i Specializuar kishte marrë Aktgjykimin e ankimuar, duke e vërtetuar Vendimin e AL-së pa ndonjë analizë të mjaftueshme të fakteve relevante, jo në përputhje me ligjin, e që përcaktojnë të drejtën e punëtorëve për shumën e cila u takon nga një ndarje e tillë e mjeteve financiare.

Në procedurën e rigjyimit, Kolegji i Specializuar duhet të analizoj të gjitha faktet relevante për të drejtat e punëtorëve, për shumën që u takojnë, kriteret sipas të cilave është bërë një ndarje e tillë, që për më shumë duket të jetë arbitrare e pa u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi. Kolegji i Specializuar duhet në mënyrë specifike të përcaktoj nëse shuma që i është ndarë ankuesit është adekuate, me kriteret e përcaktuara, nëse ka pasur kritere të tilla dhe të marrë një vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj.

Në linjën e cekur më lartë të arsyetimit ligjor, për raste të këtilla siç është edhe ky rast, në jurisprudencën e vet të më parme, Kolegji i Apelit ka vendosur edhe në rastet tashmë të mbyllura AC-I-14-0346, AC-I-15-0027 dhe AC-I-16-0263.

Për arsyet e lartë cekura, pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara dhe Kolegji i Apelit e aprovon ankesën dhe e anulon aktgjykimin e ankimuar si joligjor duke kthyer lëndën në rigjykim.

Andaj, në bazë të nenit 9.10 të LDHP-së , Kolegji i Apelit vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Taksat Gjyqësore

Nuk caktohen taksa gjyqësore, pasi që ankuesi tashmë e ka paguar taksën me datë 23/05 /2016.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 26 shtator 2019.

Ilmi Bajrami, Gjyqtar kryesues

URDHËR PËR ZYRËN E REGJISTRIMIT:

Ju lutem dërgojeni këtë Aktvendim tek:

- Ankuesi,
- E paditura,
- Gjyqtarit të vetëm me kompetenca të deleguara të Kolegjit të Specializuar të DHPGJS-së, në lëndën C-IV-13-2827

Ilmi Bajrami, Gjyqtar Kryesues
